1436	Zyrtar për shpenzime	SHC-1436	Profesional 2	Grupi i buxhetit dhe financave	Ekonomik, financa apo kontabilitet

1437	Zyrtar për shpëzori, blerari dhe peshkatar	SHC-1437	Profesional 2	Grupi i bujqësisë, pylltarisë dhe tokës	Agronomi/ Pylltari/i lërkulturore/Shkençet e Tokës, Gjeografi, Veterinari.
1438	Zyrtar për shqyrtimin e ankesave	SHC-1438	Profesional 2	Grupi ligjor	Juridik.
1439	Zyrtar për shtetësi	SHC-1439	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arsim i lartë i paspecifikuar
1440	Zyrtar për siguri rrugore	SHC-1440	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arsim i lartë i paspecifikuar
1441	Zyrtar për sistemin informativ të pylltarisë, mirëmbajtje dhe përkrahje	SHC-1441	Profesional 2	Grupi i shkencave natyrore	Biologji, Zoologji, Agrikuturë, Hortikuturë, Pylltari, Gjeografi, Fizikë, Kimi, Matematikë, Ekologji, Agronomi, Veterinari, Mjedis.
1442	Zyrtar për sistemin informativ ujor	SHC-1442	Profesional 2	Grupi i teknologjisë informative	Shkencave kompjuterike, Inzhinieri kompjuterike dhe softuerike, Informatikë inzhinierike, Teknologji e informacionit dhe Telekomunikim, Informatikë dhe Teknologji informative, Inzhinieri Elektroteknike Kompjuterike me Telekomunikacion.
1443	Zyrtar për shtesa pensionale	SHC-1443	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arsim i lartë i paspecifikuar
1444	Zyrtar për sponsorizim në kulturë	SHC-1444	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	Juridik, Ekonomik (në specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shtetësi Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike.

1445	Zyrtar për sponzorizim në rinë	SHC-1445	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arsim i lartë i paspecifikuar.
1446	Zyrtar për sponzorizim në sport	SHC-1446	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arsim i lartë i paspecifikuar.
1447	Zyrtar për sport	SHC-1447	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arsim i lartë i paspecifikuar.
1448	Zyrtar për statistika	SHC-1448	Profesional 2	Grupi i statistikës	Matematikë, Ekonomi, Gjeografi.
1449	Zyrtar për statistika të asimit.	SHC-1449	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkencë Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike.
1450	Zyrtar për statistika të kulturës dhe sportit	SHC-1450	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkencë Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike.
1451	Zyrtar për statistika së tregut të punës	SHC-1451	Profesional 2	Grupi i statistikës	Matematikë, Ekonomi, Gjeografi.
1452	Zyrtar për stenografi	SHC-1452	Profesional 2	Grupi i marrëdhënieve me publikun dhe informimin	Gazetar/Shkencë Komunikimi, Gjuhë dhe Letërsi, Marrëdhënie me Publikun, Marketing.

1453	Zyrtar për strategji		SHC-1453	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkencë Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeograf, Administratë Publike
1454	Zyrtar për strehim		SHC-1454	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkencë Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeograf, Administratë Publike
1455	Zyrtar për strehim familjar dhe kujdestari		SHC-1455	Profesional 2	Grupi i përgjithshëm i shërbimeve sociale	Psikologji/ Sociologji, Punë Sociale, Logopedi
1456	Zyrtar për studime maister		SHC-1456	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkencë Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeograf, Administratë Publike
1457	Zyrtar për studime të doktoratës		SHC-1457	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkencë Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeograf, Administratë Publike
1458	Zyrtar për subvencione operative dhe tatim		SHC-1458	Profesional 2	Grupi i përgjithshëm i tatim-taksave apo mbledhjes së të ardhurave	Juridik/ Ekonomik (pavarësisht nga specializimi)
1459	Zyrtar për taksë komunale		SHC-1459	Profesional 2	Grupi i përgjithshëm i tatim-taksave apo mbledhjes së të ardhurave	Juridik/ Ekonomik (pavarësisht nga specializimi)
1460	Zyrtar për tatimin në pronë		SHC-1460	Profesional 2	Grupi i përgjithshëm i tatim-taksave apo mbledhjes së të ardhurave	Juridik/ Ekonomik (pavarësisht nga specializimi)

1461	Zyrtar për të drejta të familjeve	SHC-1461	Profesional 2	Grupi i përgjithshëm i shërbimeve sociale	Psikologji/ Sociologji, Punë Sociale, Logopedi.
1462	Zyrtar për të drejta të njeriut dhe barazi gjinore	SHC-1462	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkencë Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike.
1463	Zyrtar për të drejta të avioudhëtarëve	SHC-1463	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arsim i lartë i paspecifikuar.
1464	Zyrtar për të drejta të njeriut	SHC-1464	Profesional 2	Grupi i shkencave aboqërore	Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkencë Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike.
1465	Zyrtar për të drejtën ujore	SHC-1465	Profesional 2	Grupi i dheut dhe ujtrave	Kimi, Kimi Industriale, Teknologji e Përgjithshme, Inzhinieri Kimike, Bujqësi, Inzhinieri e Ujtrave.
1466	Zyrtar për të huaj	SHC-1466	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arsim i lartë i paspecifikuar.
1467	Zyrtar për të hyra financiare	SHC-1467	Profesional 2	Grupi i buxhetit dhe financave	Ekonomik, financa apo kontabilitet.
1468	Zyrtar për të hyra nga burimet vetanake	SHC-1468	Profesional 2	Grupi i përgjithshëm i zym-akusave apo mbledhjes së të ardhurave	Juridik/ Ekonomi (pavarësisht nga specializimi).

1469	Zyrtar për të mirat		SHC-1469	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkencë Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike.
1470	Zyrtar për teknologji informativë		SHC-1470	Profesional 2	Grupi i teknologjisë informativë	Shkencave kompjuterike, Inzhinieri kompjuterike dhe softuerike, Informatikë inzhinierike, Teknologji e informacionit dhe Telekomunikim, Informatikë dhe Teknologji Informativë, Inzhinieri Elektroteknike Kompjuterike me Telekomunikacion.
1471	Zyrtar për trafik		SHC-1471	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arsim i lartë i paspecifikuar.
1472	Zyrtar për trajtime		SHC-1472	Profesional 2	Grupi i burimeve njerëzore	Juridik, Ekonomik, Psikologji, Administratë Publike, Pedagogji, Menaxhim i Burimeve Njerëzore.
1473	Zyrtar për trajtimin e të burgosurve dhe çështje sociale		SHC-1473	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkencë Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike.
1474	Zyrtar për transaksione të likuidimit		SHC-1474	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkencë Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike.
1475	Zyrtar për transparencë komunale		SHC-1475	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkencë Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike.
1476	Zyrtar për transport		SHC-1476	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arsim i lartë i paspecifikuar.

1477	Zyrtar për transport dhe trafik	SHC-1477	Profesional 2	Grupi i inzhinierisë mekanike	Prodhimi dhe inzhinieri industriale me Mienachment, Termozergjësia dhe Energi të Riputerishme, Dizajn Inzhinierik dhe Automjete, Komunikacion dhe Transport, Mekanikë.
1478	Zyrtar për transport të jashtëzakonshëm	SHC-1478	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arsim i lartë i paspecifikuar.
1479	Zyrtar për transportin e mallrave	SHC-1479	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arsim i lartë i paspecifikuar.
1480	Zyrtar për transportin rrugor	SHC-1480	Profesional 2	Grupi i inzhinierisë së ndërtimit	Inzhinieri e Ndërtimit, Inzhinier Strukturore, Inzhinieri Arkitekturore, Inzhinieri Gjeoteknike, Hidroteknike
1481	Zyrtar për trashëgimi	SHC-1481	Profesional 2	Grupi i përgjithshëm i trashëgimisë kulturore	Histori, Histori e Artit Arkologjik, Etimologji, Antropologji, Arkitekturë, Arkitekturë polizashi, Konservim Urban, Arte të bukura (pikturë, skulpturë, dizajn grafik, muzikë), Kuratori, Muzeologji, Orientalistika, Gjeografi.
1482	Zyrtar për trashëgimi kulturore dhe arkiv të gjentë	SHC-1482	Profesional 2	Grupi i përgjithshëm i trashëgimisë kulturore	Histori, Histori e Artit Arkologjik, Etimologji, Antropologji, Arkitekturë, Arkitekturë polizashi, Konservim Urban, Arte të bukura (pikturë, skulpturë, dizajn grafik, muzikë), Kuratori, Muzeologji, Orientalistika, Gjeografi.
1483	Zyrtar për ujëra	SHC-1483	Profesional 2	Grupi i dheut dhe ujërave	Kimi, Kimi Industriale, Teknologji e Përgjithshme, Inzhinieri Kimike, Biogjeshi, Inzhinieri e Ujërave.
1484	Zyrtar për ujëra dhe kullim	SHC-1484	Profesional 2	Grupi i shkencave natyrore	Biologji, Zoologji, Agrikulturë, Hortikulturë, Pylltari, Gjeografi, Fizika, Kimi, Matematikë, Ekologji, Agromomi, Veterinari, Mjedis.

1485	Zyrtar për urbanizim dhe planifikim	SHC-1485	Profesional 2	Grupi i inxhinierisë së ndërtimit	Inxhinieri e Ndërtimit, Inxhinier Strukturore, Inxhinieri Arkitekturore, Inxhinieri Gjeoteknike, Hidroteknika.
1486	Zyrtar për vendburime minerale	SHC-1486	Profesional 2	Grupi i inxhinierisë minerare	Metalurgji Ekstraktive/ Inxhinier për Miniera/ Inxhinier për nxjerrjen e naftës dhe gazit natyror, Inxhinier i Nubeturisë, Inxhinier i Gjeologjisë.
1487	Zyrtar për verifikimin e të dhënave personale	SHC-1487	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arsim i lartë i paspecifikuar.
1488	Zyrtar për vetëdijësim të publikut për rreziket nga zjarri	SHC-1488	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arsim i lartë i paspecifikuar.
1489	Zyrtar për veterinar	SHC-1489	Profesional 2	Grupi i veterinarisë	Veterinari.
1490	Zyrtar për viza	SHC-1490	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arsim i lartë i paspecifikuar.
1491	Zyrtar për vlefshmërinë ajrore	SHC-1491	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arsim i lartë i paspecifikuar.
1492	Zyrtar për vlerësim dhe akreditim	SHC-1492	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arsim i lartë i paspecifikuar.

1493	Zyrtar për vlerësim financiar për licencim	SHC-1493	Profesional 2	Grupi i buxhetit dhe financave	Ekonomik, financa apo kontabilitet
1494	Zyrtar për vlerësim financiar për sponsorizim	SHC-1494	Profesional 2	Grupi i buxhetit dhe financave	Ekonomik, financa apo kontabilitet
1495	Zyrtar për vlerësim financiar të mbështetës së federatave sportive	SHC-1495	Profesional 2	Grupi i buxhetit dhe financave	Ekonomik, financa apo kontabilitet
1496	Zyrtar për vlerësim profesional dhe verifikim	SHC-1496	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkencë Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administrim Publik.
1497	Zyrtar për vlerësim të gjendjes së ajrit dhe zhurmës	SHC-1497	Profesional 2	Grupi i eliasë së ajrit	Kim, Kimi Industriale/Teknologji e Përgjithshme, Inzhinieri Kimike/Inzh. Teknologjise së Përgjithshme.
1498	Zyrtar për vlerësim të gjendjes së mbeturinave, kimikave dhe materieve të rrezikshme	SHC-1498	Profesional 2	Grupi i përgjithshëm i mjedistit	Inzhinieri Mjedis/ Mjedis/ Kimi e Përgjithshme, Biologji, Ekologji, Gjeografi.
1499	Zyrtar për vlerësim të gjendjes së ujërave sipërfaqësore dhe nënoksore	SHC-1499	Profesional 2	Grupi i dhiesit dhe ujërave	Kim, Kimi Industriale, Teknologji e Përgjithshme, Inzhinieri Kimike, Biologji, Inzhinieri e Ujërave
1500	Zyrtar për vlerësim të konformitetit ligjor për licencim	SHC-1500	Profesional 2	Grupi ligjor	Juridik.

No.	Description of the work	Date	Time	Remarks
101	Preparation of the report on the progress of the work	10/10/2023	10:00 AM - 12:00 PM	The report is ready for submission.
102	Group discussion on the progress of the work	10/10/2023	10:00 AM - 12:00 PM	The group discussed the progress of the work and the report.
103	Preparation of the report on the progress of the work	10/10/2023	10:00 AM - 12:00 PM	The report is ready for submission.
104	Group discussion on the progress of the work	10/10/2023	10:00 AM - 12:00 PM	The group discussed the progress of the work and the report.
105	Preparation of the report on the progress of the work	10/10/2023	10:00 AM - 12:00 PM	The report is ready for submission.
106	Group discussion on the progress of the work	10/10/2023	10:00 AM - 12:00 PM	The group discussed the progress of the work and the report.
107	Preparation of the report on the progress of the work	10/10/2023	10:00 AM - 12:00 PM	The report is ready for submission.
108	Group discussion on the progress of the work	10/10/2023	10:00 AM - 12:00 PM	The group discussed the progress of the work and the report.
109	Preparation of the report on the progress of the work	10/10/2023	10:00 AM - 12:00 PM	The report is ready for submission.
110	Group discussion on the progress of the work	10/10/2023	10:00 AM - 12:00 PM	The group discussed the progress of the work and the report.

1509	Zyrtar për zhvillim		SHC-1509	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arsim i lartë i paspecifikuar.
1510	Zyrtar për zhvillim profesional të mesimdhënësve		SHC-1510	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arsim i lartë i paspecifikuar.
1511	Zyrtar për zhvillim rajonal të balancuar		SHC-1511	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arsim i lartë i paspecifikuar.
1512	Zyrtar për zhvillim rural dhe bujqësor		SHC-1512	Profesional 2	Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës	Agronomi/ Pylltari/Hortikulturë/Shkencat e Tokës, Gjeografi, Veçimtar.
1513	Zyrtar për zhvillim socio-ekonomik		SHC-1513	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkencat Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratat Publike
1514	Zyrtar për zhvillim socio-ekonomik		SHC-1514	Profesional 2	Grupi i ekonomisë	Ekonomi (pavarësisht nga specializimi).
1515	Zyrtar për zhvillim të kapaciteteve për mekanizmat koordinues lokal për imazhe nga dhuna në familje		SHC-1515	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkencat Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratat Publike
1516	Zyrtar për zhvillim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme		SHC-1516	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arsim i lartë i paspecifikuar.

1517	Zyrtar për zhvillim të performancës komunale	SHC-1517	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arzim i lartë i paspecifikuar.
1518	Zyrtar për zhvillim të projekteve infrastrukturore	SHC-1518	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arzim i lartë i paspecifikuar.
1519	Zyrtar për zhvillim të qëndrueshëm komunal	SHC-1519	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkencë Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike.
1520	Zyrtar për zhvillim të zonave ekonomike	SHC-1520	Profesional 2	Grupi i ekonomisë	Ekonomi (pavarësisht nga specializimi).
1521	Zyrtar për zhvillimin e kapaciteteve për buxhetimin e përgjithshëm gjinor	SHC-1521	Profesional 2	Grupi i buxhetit dhe financave	Ekonomik, financa apo kontabilitet.
1522	Zyrtar për zhvillimin e ndërmarrësive	SHC-1522	Profesional 2	Grupi i ekonomisë	Ekonomi (pavarësisht nga specializimi).
1523	Zyrtar për zhvillimin lokal, ekonomik dhe turistik	SHC-1523	Profesional 2	Grupi i ekonomisë	Ekonomi (pavarësisht nga specializimi).
1524	Zyrtar për zhvillimin rural	SHC-1524	Profesional 2	Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës	Agronomi/ Pylltari/Hortikulturë/Shkencat e Tokës, Gjeografi, Veçirimi.

1525	Zyrtar për zonat e mbrojtura	SHC-1525	Profesional 2	Grupi i përgjithshëm i mjedistit	Inzhinieri Mjedisit/ Mjedisit/ Kimi e Përgjithshme, Biologji, Ekologji, Gjeografi.
1526	Zyrtar për zotim të mjeteve buxhetore	SHC-1526	Profesional 2	Grupi i buxhetit dhe financave	Ekonomik, financat apo kontabilitet.
1527	Zyrtar sprovoes	SHC-1527	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	Juridik, Ekonomik (pa specifiktim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkencat Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike.
1528	Zyrtarë i lartë i TI-së për arkitektura të ofituar	SHC-1528	Profesional 1	Grupi i teknologjisë së të ofituar	Shkencat për të dhëna, Inzhinier për të dhëna, Shkencat Statistike, Shkencat kompjuterike, Inzhinieri kompjuterike dhe softuerike, Informatikë, Inzhinieri, Teknologji e informacionit dhe Telekomunikim, Informatikë dhe Informatikë Informative, Inzhinieri Elektrotronike Kompjuterike me Telekomunikacion.
1529	Zyrtarë i lartë për arkitekturë të infrastrukturës së TI-së	SHC-1529	Profesional 1	Grupi i teknologjisë informative	Shkencat kompjuterike, Inzhinieri kompjuterike dhe softuerike, Informatikë, Inzhinieri, Teknologji e informacionit dhe Telekomunikim, Informatikë dhe Teknologji Informative, Inzhinieri Elektrotronike Kompjuterike me Telekomunikacion.
1530	Zyrtarë i lartë për arkitekturë të sigurisë së informacionit	SHC-1530	Profesional 1	Grupi i teknologjisë informative	Shkencat kompjuterike, Inzhinieri kompjuterike dhe softuerike, Informatikë, Inzhinieri, Teknologji e informacionit dhe Telekomunikim, Informatikë dhe Teknologji Informative, Inzhinieri Elektrotronike Kompjuterike me Telekomunikacion.
1531	Zyrtarë i lartë për inovacion dhe hulumtim	SHC-1531	Profesional 1	Grupi i administrimit të përgjithshëm	Arsim i lartë i paspecifikuar.
1532	Zyrtarë i lartë i TI-së për arkitekturë të proceseve	SHC-1532	Profesional 1	Grupi i teknologjisë informative	Shkencat kompjuterike, Inzhinieri kompjuterike dhe softuerike, Informatikë, Inzhinieri, Teknologji e informacionit dhe Telekomunikim, Informatikë dhe Teknologji Informative, Inzhinieri Elektrotronike Kompjuterike me Telekomunikacion.

1533	Zyrtarë i lartë i TI-së për planifikim dhe menaxhim të projekteve	SHC-1533	Profesional 1	Grupi i teknologjisë informative	Shkencave kompjuterike, Inzhinieri kompjuterike dhe softuerike, Informaticë inzhinierike, Teknologji e informacionit dhe Telekomunikim, Informaticë dhe Teknologji informative, Inzhinieri Elektroteknike Kompjuterike me Telekomunikacion.
1534	Zyrtarë për bartim të numrave	SHC-1534	Profesional 2	Grupi i teknologjisë informative	Shkencave kompjuterike, Inzhinieri kompjuterike dhe softuerike, Informaticë inzhinierike, Teknologji e informacionit dhe Telekomunikim, Informaticë dhe Teknologji informative, Inzhinieri Elektroteknike Kompjuterike me Telekomunikacion.
1535	Zyrtarë i lartë për njohjen e mësimi paraprak	SHC-1535	Profesional 1	Grupi i shkencave shoqërore	Juridik, Ekonomik (pa specifim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkencë Politike, Politologji, Punë Sociale, Gjeograf, Administratë Publike.
1536	Zyrtarë i lartë për përfaqësim dhe standardizim	SHC-1536	Profesional 1	Grupi ligjor	Juridik.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/226
Datë: 23.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 5 paragrafit 5. dhe neni 25 paragrafi 3. të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronat Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2024, merr këtë:


V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Qeverisë Nr. 03/30 të datës 12 maj 2020, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin Nr. 07/106 të datës 9 nëntor 2022

1. Vendimit të Qeverisë Nr. 03/30 të datës 12 maj 2020, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin Nr. 07/106 të datës 9 nëntor 2022, paragrafit 2 i shtohen 2 nën-paragraf me tekstin si në vijim:
 - 2.2. Shoqatës "ITP Prizren" i jepet e drejta që të parashtoj kërkesë në institucionet përgjegjëse për ndarjen (parcelizimin) e parcelës kadastrale P-71813068-05290-0;
 - 2.3. Duke u bazuar në paragrafin 2.2 të këtij vendimi, parcela kadastrale me Nr. P-71813068-05290-0 me rastin e ndarjes në parcela të reja, të njëjtat do të regjistrohen në emër të Republikës së Kosovës si pronare, me të drejtën e shfrytëzimit për 99 vite në emër të Shoqatës "ITP Prizren".
2. Ndryshohet nën-paragrafi 6.3 i paragrafit 6 të vendimit të Qeverisë Nr.03/30 të datës 12 maj 2020, me tekstin si në vijim:
 - Nëse shuhet Shoqata "ITP Prizren", falimenton apo vepron në kundërshtim me këtë vendim, detyrimet e Shoqatës në lidhje me Parkun Gjermano – Kosovar të Inovacionit dhe Trajnimit realizohen bazuar në Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve.
3. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit të Qeverisë Nr. 03/30 të datës 12 maj 2020 dhe vendimit Nr. 07/106 të datës 9 nëntor 2022.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/226
Datë: 23.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 23 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Emërohet Komisioni Ad hoc për Vlerësimin Profesional për Pranim për Pozitën e Kategorisë së Lartë Drejtuese: Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë për Barazi Gjinore, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, në këtë përbërje:
 - Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, kryesues;
 - Anita Kalendar, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Drejtësisë, anëtare;
 - Lumnije Demi, Drejtoreshë e Përgjithshme, Agjencia për Informim dhe Privatësi, anëtare;
 - Fatime Bajraktari, Zyrtare e Lartë e Personelit në Agjencinë për Barazi Gjinore-Zyra e Kryeministrit, anëtare dhe
 - Valdete Avdyli, Eksperte e Jashtme, anëtare.
- Obligohet Komisioni i lartpërmendur t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/226
Datë: 23.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11 paragrafi 10 i Ligjit nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT PËR ZYREN PËR ÇËSHTJE TË KOMUNITETEVE PËR
VITIN 2024

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i Programit për Zyrën për Çështje të Komuniteteve (referuar tutje Programi) është mbështetja financiare dhe promovimi i të drejtave dhe interesave për të gjitha komunitetet jo shumicë në Republikën e Kosovës. Për këtë, programi do fokusohet në projektet të cilat avancojnë të drejtat e komuniteteve joshumicë, bazuar në përvojë të gjatë të dëshmuar, për rezultate më të mira si qëllim kryesor i mbështetjes përmes këtij Programi.

Zyra për Çështje të Komuniteteve (referuar tutje ZÇK), buxhetin e saj e shfrytëzon për:

- Mbështetje financiare për mediat në gjuhët e komuniteteve jo shumicë, për realizimin e projekteve që kanë për qëllim promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve joshumicë në Republikën e Kosovës.
- Mbështetje financiare për organizatat joqeveritare për realizimin e projekteve që kanë për qëllim promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve jo-shumicë në Republikën e Kosovës, aftësimin dhe punësimin e komuniteteve jo-shumicë me theks të veçantë për të rinjtë dhe gratë, ose grupet tjera të marginalizuara brenda komuniteteve jo-shumicë.
- Mbështetje financiare për aktivitete që kanë për qëllim ruajtjen dhe kultivimin e kulturës dhe traditave të komuniteteve jo-shumicë.
- Bursa për Studentët e komuniteteve jo-shumicë.
- Asistencë dhe mbështetje financiare për qytetarët e komuniteteve joshumicë të Republikës së Kosovës sipas kritereve të përcaktuara me këtë Program dhe bazuar në legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Programi zbatohet nga Zyra për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit.
2. Buxheti i ndarë për ZÇK/ZKM për subvencionimin e mediave, realizohet në bazë të këtij Programi si dhe përshtatshëmrisht zbatohen dispozitat e Rregullores së Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
3. Buxheti i ndarë për ZÇK/ZKM për subvencionimin e OJQ-ve, realizohet në bazë të Rregullores së Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
4. Buxheti i ndarë për bursistët realizohet në bazë të marrëveshjeve me Universitetet/Fakultetet respektive.

Neni 3 Bashkëpunimi dhe koordinimi

1. Zyra për Çështje të Komuniteteve gjatë gjithë procesit të zbatimit të Programit për Komunitete do të bashkëpunojnë dhe do të koordinohen ngushtë me Zyrën për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit për të siguruar mos diskriminim në ndarjen e fondeve me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies për standardet dhe procedurat për ndarjen e fondeve.
2. Zyra për Çështje të Komuniteteve do të bashkëpunojë me të gjithë trupat relevantë, përfshirë këtu Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve lidhur me zbatimin e Programit, ashtu që të:
 - Sigurohet transparenca në zbatimin e të njëjtit;
 - Llogaridhënia e të gjithë zyrtarëve përgjegjës për zbatimin e Programit sipas vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
 - Zbatohet legjislacioni relevant në përpikëri;
 - Arrihet qëllimi i Programit.

Neni 4 Parimet

1. Gjatë procesit të ndarjes së subvencioneve duhet respektuar këto parime:
 - 1.1. Liria e pjesëmarrjes në thirrje;
 - 1.2. Jo diskriminimi dhe trajtimi i barabartë.
 - 1.3. Transparenca e procedurave të ndërmarra në zbatimin e Programit, duke i ofruar të gjithë parashtruesve të aplikacioneve të dhënat e nevojshme, duke përfshirë shumën minimale dhe maksimale të subvencionimit për secilin nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë që aplikojnë, si dhe numrin e projekteve që mund të aplikojnë në kuadër të thirrjes publike;
 - 1.4. Harmonizimi i qëllimeve të subvencionimit me efikasitetin e shfrytëzimit të burimeve në bazë të sistemit të konkurrimit dhe kriterëve, të cilat mundësojnë vlerësimin e kërkesave ose projekt propozimeve dhe specifikacioneve teknike për përzgjedhjen dhe ndarjen e subvencioneve;
 - 1.5. Paanshmëria e shqyrtimit të vendimeve dhe parandalimi i konfliktit të interesit;
 - 1.6. Përrjashtimi i mbivendosjes, që nënkupton ndalimin e financimit të të njëjtit shfrytëzues më shumë se një herë gjatë një viti;

- 1.7. Ndalimi i subvencionimit të njëjtit projekt nga organizatat e tjera buxhetore ose nga donatorët tjerë, përveç në rastet e bashkëfinancimit;
- 1.8. Respektimi i legjislacionit të aplikueshëm, duke përfshirë por duke mos u kufizuar me Rregulloren Nr.04/2017 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve gjatë çdo hapi procedural.

Neni 5

Fondet për mbështetjen e mediave

1. ZÇK-ja shpallë thirrje publike me qëllim të ofrimit të mbështetjes financiare për media në gjuhët e komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës.
2. Thirrja publike shpallet një (1) herë në vit në Web faqe të Zyrës së Kryeministrit, dhe në mediat elektronike. Të drejtë aplikimi kanë të gjitha mediat, të cilat i plotësojnë kushtet për aplikim të cilat i përcakton ZÇK-ja, në përputhje me këtë Program, si dhe Rregulloren e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
3. Mediat, formularët e plotësuar i dorëzojnë në ZÇK, në një zarf të mbyllur, ku brenda zarfit vendoset një kopje e printuar e të gjithë dokumentacionit origjinal të kërkuar, si dhe një kopje identike elektronike në formatin e lexueshëm në MS OFFICE. Formulari plotësohet në një nga gjuhët zyrtare, dhe afati i aplikimit është së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit të thirrjes publike.

Neni 6

Kriteret e aplikimit

1. Mediat të cilat aplikojnë për mbështetje financiare sipas thirrjes publike të publikuar nga ZÇK-ja, duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:
 - 1.1. Formulari i projekt - propozimit që shkarkohet nga Web faqja e Zyrës së Kryeministrit;
 - 1.2. Formulari i propozim buxhetit;
 - 1.3. Mediat duhet që të kenë programin në njërin nga gjuhët e komuniteteve jo shumicë në Kosovë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - 1.4. Çertifikata e regjistrimit të mediave në organin kompetent të Republikës së Kosovës, apo certifikata e regjistrimit si OJQ;
 - 1.5. Çertifikata e numrit fiskal;
 - 1.6. Letërnjoftimi i vlefshëm i udhëheqësit të medias ose personit të autorizuar, i lëshuar nga organi kompetent i Republikës së Kosovës;
 - 1.7. Raporti i fundit gjashtë (6) mujor i llogarisë bankare të medias; dhe
 - 1.8. Dokumente ose prova të burimeve të financimit/mbështetjes nga donatorët e tjerë.
2. Për produksionet e pavarura dhe mediat e shkruara, pika 1.5 e këtij neni nuk aplikohet, nëse një gjë e tillë parashihet me legjislacionin në fuqi.
3. Përveç kriterëve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, në thirrjen publike të shpallur nga ZÇK- kërkohej edhe kriteret e përcaktuara me Rregulloren MF nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Neni 7 **Komisioni vlerësues**

1. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, e themelon Komisionin vlerësues prej pesë (5) anëtarëve, 3 prej të cilëve janë zyrtarë civilë kurse dy ekspertë të përzgjedhur përmes thirrjes publike. Njëri nga këta dy anëtarë, ekspertë, do jetë përfaqësues i OJQ-ve.
2. Për përbërjen, kohëzgjatjen dhe mandatin e komisionit nga paragrafi 1. i këtij neni aplikohen dispozitat e Rregullores së Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
3. Gjatë themelimit e Komisionit vlerësues, në përbërje të komisionit, duhet t'i kushtohet një vëmendje e veçantë balancës etnike, gjinore dhe gjuhësore. Se paku një ekspert i jashtëm duhet të jetë pjesëtar i njërës nga komuniteteve jo shumicë. Po ashtu, së paku njëri nga anëtarët që vijnë nga zyrtarët civilë do jetë i gjinisë femërore.
4. Anëtarët e Komisionit duhet njohin të dy gjuhët zyrtare, në nivelin profesional.
5. Ekspertë të jashtëm për përzgjedhjen e projekteve të medias duhet të jenë ekspertë të medias.
6. Komisioni për punën e tij i raporton Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit.

Neni 8 **Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit vlerësues dhe vendimmarrja**

1. Komisioni është i obliguar që detyrat dhe përgjegjësitë, si dhe vendimmarrjen ta bëjë në përputhje me Rregulloren e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve. Po ashtu, Komisioni do bëjë punën e tij transparente për publikun dhe do vendos në bazë të kritereve të meritokracisë.

Neni 9 **Kriteret për përzgjedhjen e mediave përfituese**

1. Me rastin e shqyrtimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së mediave përfituese, Komisioni duhet t'i merr parasysh këto kritere:
 - 1.1. Përvoja dhe kapacitetet e mediave në zbatimin e projekteve paraprake të cilat kishin për qëllim avancimin e të drejtave apo zbatimin e të drejtave të komuniteteve jo shumicë, të dëshmuara përmes dokumentacionit kredibil, e që kanë për qëllim vazhdimin e punës sipas qëllimit të këtij Programi;
 - 1.2. Që punon në njërin nga gjuhët e komunitetit jo shumicë;
 - 1.3. Që priorizon projekte të cilat kanë për subjekt grupet e marginalizuara;
 - 1.4. Projekt propozimin dhe paraqitjen e shpenzimeve të cilat si rezultat kanë aktivitete si vlerë të shtuar për komunitetin.

Neni 10

Shpallja e mediave përfituese dhe procedura e ndarjes së mjeteve

Shpallja e mediave përfituese dhe procedura e ndarjes së mjeteve si dhe monitorimi i zbatimit dhe raportimi bëhet në përputhje me Rregulloren e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Neni 11

1. Vlerësimi i projekteve dhe monitorimi i zbatimit të tyre bëhet në përputhje me dispozitat e Rregullores së Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Ekipet e monitorimit caktohen me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit.

Neni 12

Programi i Ballkanistikës dhe bursat

1. Përmes këtij Programi, ndahen 30 bursa për studentët nga komunitetet jo shumicë në fusha të ndryshme, duke prioritetizuar fushat STEM.
2. Ky Program, ndan edhe 3 bursa për programin e Ballkanistikës.
3. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit do të lidh marrëveshje mirëkuptimi e bashkëpunimi me Universitetet në Republikën e Kosovës për qëllim të zbatimit të dhënies së bursave për studentët e interesuar.
4. Fituesit e bursës, mund të ftohen për praktikë në institucionet e ekzekutivit në Republikën e Kosovës.

Neni 13

Subvencionet për kategori të ndjeshme

1. Shuma në vlerën prej 150 mijë euro nga shuma totale e Programit do ndahet për grupet e ndjeshme si vijon:
 - Individët që vuajnë nga sëmundjet e rënda kronike dhe janë në gjendje të vështirë ekonomike e cila barazohet me nevojën për ndihmë sociale (të dëshmuar);
 - Pensionistët të cilët pranojnë vetëm ndihmë sociale dhe janë në nevojë imediate për terapi, barëra apo ushqim;
 - Gratë viktime të dhunës në familje, të strehuara në strehimoret në Republikën e Kosovës;
 - Nënata vetushqyese;
 - Invalidët dhe personat me nevoja të veçanta;
 - Fëmijët pa prindër nën përkujdesjen e gjyshit/gjyshes, apo anëtarëve tjerë të familjes së largët.
2. Shuma që do ju ndahet kategorive sipas pikës 1. të këtij neni bëhet në bazë të vlerësimit të Komisionit duke marrë parasysh nevojën e paraqitur të individit dhe arritjen e ndihmës signifikante personit/aplikantit në nevojë. Shuma e dhënë do bëhet publike, bashkë me arsyetimin e vendimit.
3. Aplikantët sipas kategorive nga pika 2. e këtij neni janë të obliguar të dëshmojnë gjendjen e tyre sipas dokumentacionit të vlefshëm në Republikën e Kosovës.

E DREJTA PËR ANKESË
Neni 14
Komisioni i Ankesave

1. Kundër vendimit të Komisionit Vlerësues aplikantët mund të ushtrojnë ankesë te Komisioni i Ankesave.
2. Për themelimin, përbërjen, mandatin dhe procedurat e punës së Komisionit të Ankesave, zbatohen dispozitat e Rregullores së Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
3. Në rast të evidentimit të keqpërdorimit, manipulimit, konfliktit të interesit apo çfarëdo veprimi tjetër që vë në pyetje kredibilitetin e menaxhimit të Programit, Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit do veprojë sipas kompetencave të parapara në legjislacionin për Zyrtarët Publik.

Neni 15
Subjektet të cilat nuk mund të marrin subvencione

OJQ-të dhe mediat që shkelin detyrimet ligjore apo kanë shkelur këto detyrime gjatë dy viteve të fundit, që nuk paraqesin raporte narrative dhe financiare, do të vendosen në listën e zezë që ndalon marrje të subvencioneve për një periudhë të caktuar sipas vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit. Të njëjtit do lajmërohen në organet kompetente ligj zbatuese dhe ndaj të njëjtëve do iniciohet proces gjyqësor.

Neni 16
Auditimi

Njësia përgjegjëse për Auditimin e Brendshëm në ZKM, në pajtim me legjislacionin në fuqi bënë auditimin e procedurave të subvencionimit të parapara me këtë Program.

Neni 17
Ndryshime dhe plotësime të këtij vendimi

Ky Program ndryshohet dhe plotësohet sipas procedurës së njëjtë të miratimit.

Neni 18
Hyrja në fuqi

Programi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/226

Datë: 23.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/226
Datë: 23.10.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit: Konservimi, Restaurimi dhe Ndërtimi i Kompleksit Memorial "Masakra e Reçakut" ZK Reçak, Komuna e Shtimes, sipas tabelave bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi janë raportet e vlerësimit të punuara nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabelat të bashkëngjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Subjekti Kërkues/Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK) do të paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit të caktuar në raportet e vlerësimit komfor legjislativ në fuqi.
8. Subjekti Kërkues/Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës do të paguajë plotësisht të gjitha obligimet tjera financiare që mund të rrjedhin si pasojë e procesit të shpronësimit dhe vendimet gjyqësore.
9. Ky vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratit të shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria për Kadastër e Komunës përkatëse është e obliguar të kryej veprimet procedurale për zbatimin e tij.
10. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë